



RAPORT

Titulli i Hulumtimit:

Qasja e Grave Rom, Ashkali dhe Egjiptiane në Shërbime Shëndetësore

Prishtinë, Dhjetor 2023



OPERATORI EKONOMIK:



D&D BUSINESS SUPPORT CENTER

Rr. "Xheladin Hana", Iliria Building,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 570 021
E-mail: info@dd-bsc.com
Ëeb: ëëë.dd-bsc.com

AUTORITETI KONTRAKTUES:



THE IDEAS PARTNERSHIP

Prishtinë, Republika e Kosovës
Email:
office@theideaspartnership.org

Ky studim është në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave dhe të rinjëve rom, ashkali dhe egjiptian në avokim dhe edukim shëndetësor" i cili zbatohet nga The Ideas Partnership dhe mbështetet nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ndërsa financohet nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve të D&D Business Support Center dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e The Ideas Partnership. Raporti është hartuar duke u bazuar në të dhënat nga sondazhi me gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane në komunën e Fushë Kosovës dhe në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit.

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	6
3. METODOLOGJIA	7
4. ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE	8
4.1. Vendbanimi, Etnia dhe Moshë	8
4.2. Statusi Martesor	9
4.3. Familja	10
4.4. Të ardhurat mujore	11
4.5. Edukimi dhe Punësimi	11
5. QASJA NË SHËRBIME SHËNDETËSORE	13
5.1. Shërbimet shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 dhe aktualisht	13
5.2. Qasja në shërbimet shëndetësore	16
5.3. Pengesat kulturore, gjuhësore dhe sociale në marrjen e kujdesit shëndetësor	18
5.4. Përmirësimet në shërbimet shëndetësore në 12 muajt e fundit	20
6. SFIDAT	21
7. MSIMET E NXJERRA	22
8. REKOMANDIMET	23
9. KONKLUZIONI	24
10. Annex A – Pyetësi	25

FIGURAT

Figura 1. Etnia.....	9
Figura 2. Vendbanimi.....	9
Figura 3. Mosha.....	9
Figura 4. Statusi Martesor.....	9
Figura 5. Mosha kur janë martuar.....	10
Figura 6. Femijët.....	10
Figura 7. Të dhënat rreth fëmijëve.....	11
Figura 8. Skema Sociale.....	11
Figura 9. Edukimi.....	12
Figura 10. Arsyjet e ndërprerjes së mësimi.....	12
Figura 11. Punësimi.....	13
Figura 12. Shërbimet shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19.....	13
Figura 13. Arsyjet e mosmarrjes së shërbimeve gjatë pandemisë COVID-19.....	14
Figura 14. Informimi rreth shërbimeve shëndetësore.....	14
Figura 15. Infektimi me COVID-19.....	15
Figura 16. Trajtimi.....	15
Figura 17. Shërbimet shëndetësore.....	16
Figura 18. Qasja në shërbimet shëndetësore.....	16
Figura 19. Sfidat gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore.....	17
Figura 20. Sfidat e specifikuar.....	17
Figura 21. Pengesat në marrjen e kujdesit shëndetësor.....	18
Figura 22. Kënaqëshmëria me performancën dhe shërbimet e institucioneve shëndetësore.....	18
Figura 23. Ndihtmat.....	19
Figura 24. Barnatoret në QKMF-ja.....	19
Figura 25. Përmirësimet në 12 muaj e fundit.....	20
Figura 26. Përmirësimet.....	20

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Grupet e marginalizuara, siç janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, historikisht preken gjithmonë më shumë nga pandemitë dhe katastrofat natyrore si pasojë e kushteve të rënda socio-ekonomike. Duke qenë se këto komunitete kanë vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore, shpeshherë jetojnë në rrethana që e shtojnë probabilitetin ndaj sëmundjeve të ndryshme. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të analizohen politikat e nivelit qendror dhe të atij lokal për adresimin e nevojave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në kohë krizash.

Ky hulumtim ofron një pasqyrë të të dhënave të mbledhura, metodologjinë e zhvilluar, rezultatet e grumbulluara, sfidat e hasura, mësimet e nxjerrura si dhe rekomandimet për përmirësimin e shërbimeve shëndetsore në të ardhmen.

Pas hulumtimit dhe intervistave gjithëpërfshirëse me 200 gra nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës dhe fshatit të Janjevës, rezultatet treguan një pikturë të qartë të sfidave që këto gra hasin në shërbimet shëndetësore. Përvoja e tyre u vlerësua në mënyrë të hollësishme për të identifikuar problemet kryesore dhe për të siguruar një mjedis shëndetësor cilësor dhe të barabartë për to, duke u përqëndruar në të arriturat dhe sfidat e identifikuara.

Përmes këtij hulumtimi janë evidentuar eksperiencat e grave në qasjen në shërbimet shëndetësore, sfidat, dhe vështirësitë të cilat janë si në vijim:

- ❖ **Mungesa e qasjes në shërbimet shëndetësore:** Gratë nga këto komunitete përballen me vështirësi në marrjen e kujdesit shëndetësor për shkak të barrierave si diskriminimi, mungesa e informacionit, dhe pengesat kulturore.
- ❖ **Mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit:** Shumë prej tyre nuk janë të informuara për të drejtat e tyre shëndetësore dhe për burimet që kanë në dispozicion. Kjo mungesë e informacionit bën që gratë të kenë vështirësi në pranimin e kujdesit shëndetësor që u nevojitet.
- ❖ **Barrierat gjuhësore dhe kulturore:** Gjuha dhe kultura shpeshherë janë pengesë për këto gra në kuptimin e shërbimeve shëndetësore dhe në marrjen e ndihmës së duhur.
- ❖ **Mungesa e besimit dhe frika e diskriminimit:** Disa gra kanë frikë ndaj diskriminimit prej institucioneve shëndetësore, gjë që i pengon ato të kërkojnë ndihmë shëndetësore në kohë të nevojshme.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Duke pasur parasysh që pandemia COVID-19 ka qenë dhe mbetet një fenomen i cili ka pasur ndikim negativ në të gjithë botën, kjo sigurisht që ka ndikuar edhe në shërbimet shëndetësore e veqanarisht tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë dhe Janjevë.

Konsideruar rëndësinë e qasjes së grave në shërbimet shëndetësore, nevoja për hulumtimin e gjendjes reale dhe avokimit në institucionet relevante për përmirësimin e këtyre shërbimeve është e pashmangshme, andaj The Ideas Partnership ka kontraktuar kompaninë konsulente D&D Business Support Center për të zhvilluar hulumtimin i cili nxjerr në pah sfidat dhe përvojat e grave gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është finalizimi i hulumtimit kualitativ dhe kuantitativ i cili prodhon një përmbledhje të politikave në qasjen e grave nga komunitetet jo-shumicë në shërbimet shëndetësore. Hulumtimi synoi të mbledhë informacione mbi përvojën e tyre, cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe të propozojë rekomandime për të përmirësuar qasjen dhe kujdesin shëndetësor për këto komunitete.

Ky dokument do të përdoret për të avokuar në institucionet relevante për kujdesin shëndetësor dhe cilësor të grave.

Për ta realizuar këtë, ne jemi fokusuar në disa qëllime kryesore si:

Identifikimi i sfidave: Qëllimi kryesor ishte identifikimi dhe dokumentimi i sfidave thelbësore që këto gra hasin në aksesimin e shërbimeve shëndetësore. Përshkrimi i këtyre sfidave është jetësor për të kuptuar problemet kryesore me të cilat ballafaqohen ato.

Vlerësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor: Një tjetër qëllim është vlerësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësorë që u ofrohet këtyre grave. Kjo përfshin krahasimin e kujdesit të tyre me standardet e rekomanduara, duke vlerësuar nëse ato përputhen dhe nëse jo, identifikimin e aspekteve që duhet përmirësuar.

Nxjerrja e rekomandimeve dhe zhvillimi i politikave: Përtej identifikimit të sfidave, qëllimi është të hartohen rekomandime konkrete dhe politika që do të ndihmojnë në përmirësimin e qasjes së grave nga këto komunitete në shërbimet shëndetësore. Synimi është të sigurohet një kujdes shëndetësor cilësor dhe i barabartë për to, duke u bazuar në të dhënat dhe rezultatet e hulumtimit.

Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore: Nëpërmjet identifikimit dhe adresimit të barrierave të mundshme, synohet të përmirësohet qasja e grave dhe e të rinjve nga këto komunitete në shërbimet shëndetësore.

Për të arritur këtë, është përpiluar një pyetësor i drejtuar ndaj 200 grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. 150 gra janë intervistuar në komunën e Fushë Kosovës dhe 50 gra janë intervistuar në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit.

Gjatë hulumtimit paraprak të bërë, kemi konkluduar se në komunën e Fushë Kosovës, jo domosdoshmërisht çdo lagje është e banuar nga komunitetet e synuara nga projekti. Si rrjedhojë e kësaj, ne kemi parashikuar që hulumtimi të bëhet kryesisht në lagjet 028 dhe 029 pasi që këto lagje janë më së shumti të banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Ky dokument do të luajë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e masave specifike që duhet të merren për të përmirësuar qasjen dhe kujdesin shëndetësor për këto grupe të caktuara.

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij hulumtimi është ndërtuar në dy pjesë kryesore, të fokusuara në grumbullimin e të dhënave demografike dhe përvojën e grave në qasjen e shërbimeve shëndetësore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Duke pasur synim arritjen e këtij qëllimi, fillimisht është përpiluar një pyetësor që ka përfshirë biseda të drejtpërdrejta me 200 gra nga përfaqesitë etnike rom, ashkali, dhe egjiptian. Pyetjet janë hartuar me kujdes duke marrë parasysh periudhën gjatë pandemisë edhe atë aktuale përmes mendimeve të të intervistuarëve për të adresuar sfidat dhe temat lidhur me qasjen dhe kujdesin shëndetësor të këtyre grave.

Ky pyetësor ka shërbyer si burim kryesor për identifikimin e problematikave kryesore në qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 dhe asaj aktuale. Informacioni i grumbulluar nga ky pyetësor ka qenë bazë për analizë dhe rekomandime në fushën e studimit tonë.

Pyetësori është ndarë në dy pjesë kryesore:

❖ **PJESA E PARË** – Kjo pjesë e pyetësorit kishte për qëllim grumbullimin e informacioneve themelore mbi të dhënat demografike të grave të këtyre komuniteteve, duke përfshirë etninë, vendbanimin, moshën, statusin martesor, situatën familjare, përfshirjen në skemat sociale, të ardhurat mujore, nivelet e edukimit, dhe punësimin e tyre.

Këto informacione janë të rëndësishme për të kuptuar bazën e grave në hulumtim dhe qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore.

❖ **PJESA E DYTË** – Kjo pjesë e pyetësorit ka përmbajtur pyetje që kishin për qëllim të zbulojnë se a kanë marrë këto gra shërbime shëndetësore, nëse jo pse nuk kanë marrë, sa janë të kënaqur me performancën dhe shërbimet e institucioneve

shëndetësore, a kanë pranuar ndihma, a janë të vetëdijshëm për barnatoret që ekzistojnë në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe të dokumentojnë sfidat të cilat hasin gjatë marrjes së këtyre shërbimeve.

Këto informacione kanë shërbyer për të kuptuar më mirë përvojën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane në qasjen e shërbimeve shëndetësore dhe për të hartuar rekomandime në përputhje me të dhënat e grumbulluara.

Tutje, pas hartimit të pyetësorit, është zhvilluar trajnimi i intervistuesve për të siguruar profesionalizmin dhe etikën në intervistimet me respondentet.

Pas përfundimit të këtyre aktiviteteve kemi vazhduar punën në teren ku të dhënat primare të mbledhura në këtë hulumtim janë bërë përmes vizitave fizike, dhe komunikimit online me gratë e targetura, pastaj këto të dhëna janë përpiluar në platformën KOBO Toolbox.

Ky proces ka qenë thelbësor për të kuptuar eksperiencën dhe sfidat e grave në këto komunitete në qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore dhe për të hartuar rekomandime në përputhje me të dhënat e grumbulluara.

4. ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE

4.1. Vendbanimi, Etnia dhe Moshja

Sipas të dhënave primare të hulumtimit të realizuar në komunën Fushë Kosovës (lagjet 028, 029) dhe fshatin Janjevë, është bërë një analizë e situatës së grave në këto komunitete, veçanërisht në lidhje me qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore.

Në total, janë intervistuar 150 gra në komunën Fushë Kosovës dhe 50 gra në fshatin Janjevë. Përqindja e grave të intervistuar është 75% në Fushë Kosovë dhe 25% në Janjevë.

Në Fushë Kosovë, prej 150 grave të intervistuar, 19 prej tyre i përkasin komunitetit rom, 110 janë ashkali, dhe 21 janë nga komuniteti egjiptian.

Kurse në Janjevë, nga totali i 50 grave të intervistuar, 41 prej tyre janë nga komuniteti rom dhe 9 i përkasin komunitetit ashkali.

Analiza e të dhënave tregon një përfaqësim më të madh të komunitetit ashkali në Fushë Kosovë, ndërsa në Janjevë, komuniteti rom ka një përfaqësim më të lartë krahasuar me komunitetin ashkali. Gjithashtu, është vërejtur një ndryshim në shpërndarjen e grave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në dy zonat e hulumtimit. Kjo analizë mund të jetë bazë për të kuptuar nevojat dhe qasjen e nevojshme në shërbimet shëndetësore për këto komunitete në Fushë Kosovë dhe Janjevë.

Për detaje më të hollësishme shihni grafet në vijim:




Figura 2. Etnia




Figura 1. Vendbanimi

Gratë e intervistuarat të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë në komunën e Fushë Kosovës dhe në fshatin Janjevë gjithashtu janë pyetur edhe për moshën e tyre. Përgjigjet e tyre kanë rezultuar si më poshtë.




Figura 3. Moshë

4.2. Statusi Martesor

Gjithashtu rreth pyetjes për statusin martesor, nga totali i grave të intervistuarat në Fushë Kosovë kanë rezultuar se 130 gra janë të martuara, 14 beqare, 1 e divorcuar, dhe 5 prej tyre ishin në statusin e ve.

Kurse në Janjevë nga totali 50 i grave të intervistuarat prej tyre 43 pohojnë se janë të martuara, beqare 6 dhe e ve vetëm 1.




Figura 4. Statusi Martesor

Duke pasur parasysh që martesat e hershme janë një fenomen dukshëm prezent tek vajzat dhe grateë që ju përkasin këtyre komuniteteve, ne përveç se kemi identifikuar se sa nga gratë e intervistuar janë të martuara, kemi identifikuar edhe në cilën moshë janë martuar këto gra.




Figura 5. Moshë e martesës

Bazuar në rezultatet e grumbulluara, evidentuam se grupmosha 13-24 vjeç është periudha më e zakonshme për martesat e vajzave dhe grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë edhe në komunën e Fushë Kosovës (lagjet 028 dhe 029) edhe në fshatin Janjevë. Në këto komunitete është vërejtur se martesat kanë ndodhur shpesh tek gratë midis 13 dhe 24 vjeçe, duke rezultuar në një numër të lartë të martesave në këtë grupmoshë.

4.3. Familja

Në komunën e Fushë Kosovës (lagjet 028, 029), nga 150 gra të intervistuar, 131 prej tyre kanë pohuar se kanë fëmijë, ndërsa 19 kanë pohuar se nuk kanë fëmijë.

Në Janjevë, nga 50 gra të intervistuar, 43 kanë pohuar se kanë fëmijë, ndërsa 7 prej tyre kanë pohuar se nuk janë ende prindër.

Ky informacion na ndihmon të kuptojmë se një pjesë e madhe e grave të intervistuar kanë fëmijë, ndërsa një pjesë më e vogël nuk kanë lindur fëmijë, duke ofruar një pamje mbi strukturën familjare të këtyre komuniteteve.




Figura 6. Fëmijët

Gratë të cilat kanë pohuar se kanë fëmijë janë pyetur gjithashtu edhe se sa fëmijë kanë. Të dhënat nga rezultatet e grumbulluara mund t'i shihni në tabelën e bashkangjitur më poshtë:

4.4. Të ardhurat mujore

Nëse po, sa fëmijë keni?	Fushë Kosovë	Janjevë	Total	Përqindja
1 - 3	45	16	61	35%
4 - 6	61	24	85	49%
7 - 9	25	3	28	16%
Gjithsej	131	43	174	100%

Figura 7. Të dhënat rreth fëmijëve

Pyetje tjetër e rëndësishme në këtë hulumtim ka qenë edhe se sa janë të ardhurat mujore të grave të këtyre komuniteteve, dhe sa prej grave të këtyre komuniteteve janë përfituese të skemës sociale.

Përgjigjet e tyre rreth skemave sociale kanë rezultuar si në tabelën e mëposhtme:

Përfituese e Skemës Sociale?	Fushë Kosovë	Janjevë	Total	Përqindja
Po	94	23	117	58.50%
Jo	56	27	83	41.50%
Gjithsej	150	50	200	100%

Figura 8. Skema Sociale

Sa i përket të ardhurave mujore, kemi identifikuar se në Fushë Kosovë, 68 familje kanë deklaruar të ardhura mujore deri në 150 euro, ndërsa 82 familje të tjera kanë të ardhura prej 151 deri në 300 euro;

Ndërsa në Janjevë, 30 familje deklarojnë të ardhura deri në 150 euro, ndërsa 20 familje kanë të ardhura prej 151 deri në 300 euro.

4.5. Edukimi dhe Punësimi

Gratë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptiane janë pyetur edhe rreth edukimit të tyre, kështu kemi identifikuar se sa nga to kanë edukim formal, sa nga to kanë ndërprerë shkollimin si dhe aryejet e ndërprerjes.




Figura 9. Edukimi Figura 10. Edukimi

Nga totali i grave të intervistuar në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptiane në komunën e Fushë Kosovës (lagjet 028,029) dhe në fshatin Janjevë, kemi 67 gra nga komuna e Fushë Kosovës që kanë ndërprerë shkollimin, ndërsa në Janjevë, kemi 10 gra të cilat kanë deklaruar se kanë ndërprerë shkollimin në një moshë shumë të hershme. Arsyet kryesore të ndërprerjes së shkollimit mund ti shihni në grafën e mëposhtëm.




Figura 11. Arsyet e ndërprerjes së shkollimit

Gjithashtu, rreth pyetjes se a janë të punësuar gratë e këtyre komuniteteve më poshtë mund t'i shihni informatat e marrura nga këto gra në komunën e Fushë Kosovës dhe në fshatin Janjevë.




Figura 12. Punësimi

5. QASJA NË SHËRBIME SHËNDETËSORE

5.1. Shërbimet shëndetësore gjatë pandemisë CODIV-19 dhe aktualisht

Gratë e komuniteteve rom ,ashkali dhe egjiptianë në komunën e Fushë Kosovës dhe në fshatin Janjevë, janë pyetur nëse kanë marrë shërbime shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 dhe aktualisht. Bazuar në të dhënat e grumbulluara, arritëm në përfundimin që këto gra kanë marrë shërbime shëndetësore edhe pse pandemia ishte shumë e përhapur.




Figura 13. Shërbimet shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19

Kurse, aktualisht numri i grave të cilat kanë marrë këto shërbime shëndetësore është më i madh sesa përgjatë pandemisë.

Nga totali i 150 të intervistuarave, në komunën e Fushë Kosovës kemi 106 gra që kanë pohuar që kanë marrë këto shërbime, ndërsa 44 prej tyre kanë pohuar se nuk kanë marrë shërbime shëndetësore.

Kurse në fshatin Janjevë kemi 38 gra që kanë pohuar se kanë marrë këto shërbime dhe 12 të tjera të cilat nuk kanë marrë shërbime shëndetësore.

Mund të themi që vizitat për të kryer shërbime shëndetësore nga gratë janë më të larta aktualisht në krahasim me periudhën e pandemisë.

Në lidhje me arsyet se pse gratë nga këto komunitete nuk kanë marrë shërbime shëndetësore gjatë pandemisë, informacionet më të detajuara mund t'i shihni në grafën e mëposhtëm.




Figura 14. Arsyet e mosmarrjes së shërbimeve gjatë pandemisë COVID-19

Për sa i përket informacionit rreth shërbimeve shëndetësore në këto komuna, rezultatet janë më pak të favorshme pasi shumica e tyre kanë pak informacion ose nuk kanë shumë njohuri rreth këtyre shërbimeve. Rezultatet mund t'i shihni në grafën e mëposhtëm:




Figura 15. Informimi rreth shërbimeve shëndetësore

Ne kemi identifikuar se sa prej grave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë janë janë prekur nga pandemia COVID-19. Kështu kemi identifikuar që në komunën e Fushë Kosovës, 38 prej grave kanë qenë të infektuara, ndërsa 112 gra deklaruan se nuk ishin prekur nga virusi.

Në Janjevë, 20 nga numri total i grave të intervistuar raportuan se ishin prekur nga COVID-19, ndërsa 30 prej tyre deklaruan se nuk kishin qenë të prekura nga ky virus.




Figura 16. Infektimi me COVID-19

COVID-19, në komunën e Fushë Kosovës pergjithësisht gratë kanë përdorur shërbimet shëndetësore në spitalet publike për të u trajtuar nga virusi, ndërsa shumica e grave të fshatit Janjevë kanë deklaruar se janë trajtuar në shtëpi.




Figura 17. Trajtimi

Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, gratë të cilat janë intervistuar kanë treguar se shërbimet më të zakonshme që kanë marrë janë kontrolla dhe kujdesi mjekësor në lidhje me shtatzëninë, duke i dhënë një rëndësi më të madhe. Në anën tjetër, shërbimet e

emergjencës, kirurgjia dhe rehabilitimi janë raportuar si shërbime që janë përdorur më rrallë.




Figura 18. Shërbimet shëndetësore

Ndërsa, aktualisht shërbimet shëndetësore më të shpeshta të cilat kanë shprehur se marrin gratë e këtyre komuniteteve janë kontrollat në institucionet shëndetësore.

5.2. Qasja në shërbimet shëndetësore




Figura 19. Qasja në shërbimet shëndetësore

Qasja në shërbimet shëndetësore gjatë pandemisë, në përgjithësi, ka qenë relativisht e lehtë për gratë në këto komunitete, ku edhe aktualisht, qasja në shërbimet shëndetësore vazhdon të jetë e lehtë.

Për sa i përket pyetjes në lidhje me sfidat specifike që gratë e këtyre komuniteteve kanë hasur gjatë pandemisë në fshatin Janjevë dhe në komunën e Fushë Kosovës, shumica e tyre kanë shprehur se nuk kanë hasur në ndonjë sfidë të veçantë.




Figura 20. Sfidat gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore

Ndërsa disa prej tyre kanë raportuar për sfida gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore, arsyet më të përmendura ishin mungesa e barnave dhe vështirësitë në blerjen e medikamenteve, si dhe kushtet jo të favorshme në spitale. Diskriminimi ishte një arsye që nuk u theksua shumë, ndërsa disa prej tyre nuk kanë pasur akses të mjaftueshëm në këto shërbime shëndetësore.




Figura 21. Sfidat e specifikuar

5.3. Pengesat kulturore, gjuhësore dhe sociale në marrjen e kujdesit shëndetësor

Në lidhje me pengesat kulturore, gjuhësore dhe sociale që kanë ndikuar në marrjen e kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë, arsyet më të përmendura ishin akses i kufizuar në shërbime dhe mungesa e informacionit dhe dijes.

Aktualisht, edhe pas periudhës së pandemisë, një nga pengesat më të ndjeshme që vazhdon të ndikojnë është mungesa e informacionit dhe dijes së nevojshme për të kuptuar dhe përballuar sfidat shëndetësore.




Figura 22. Pengesat në marrjen e kujdesit shëndetësor

Shumica e grave të intervistuar në komunën e Fushë Kosovës dhe në Janjevë kanë shprehur kënaqësi me performancën dhe shërbimet e institucioneve shëndetësore gjatë pandemisë.

Aktualisht, gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane vazhdojnë të shprehin kënaqësi me këto shërbime shëndetësore.




Figura 23. Kënaqëshmëria me performancën dhe shërbimet e institucioneve shëndetësore

Gjatë intervistes me gratë e këtyre komuniteteve kemi identifikuar edhe ndihmat të cilat kanë pranuar gjatë pandemisë dhe aktualisht.

Përgjigjet e tyre më të zakonshme ishin se gjatë pandemisë kishin pranuar më shumë pako higjienike dhe pako ushqimore.

Kurse, aktualisht kanë deklaruar se marrin më shumë ndihma me pako ushqimore dhe veshmbathje.




Figura 24. Ndhimat

Në bazë të të dhënave nga gratë e komuniteteve, kemi identifikuar se ndihmat të cilat kanë pranuar më së shumti janë nga organizata "The Ideas Partnership", Kryqi i Kuq dhe përfaqësuesit e komuniteteve.

Në komunën e Fushë Kosovës, nga totali i 150 grave të intervistuar, 119 prej tyre janë në dijeni se pas vizitave në QKMF, barnat esenciale ofrohen falas nga barnatoret brenda këtij institucioni, ndërsa 31 prej tyre nuk kanë informacion për këto barnatore ekzistuese brenda QKMF-së.

Ndërkohë, në komunën e Janjevës, nga totali i 50 grave të intervistuar, 45 prej tyre janë në dijeni për këtë praktikë, ndërsa 5 prej tyre nuk kanë informacion për këto barnatore ekzistuese.

10. A jeni në dijeni që mbas vizitave në QKMF, barnat esenciale ofrohen falas nga barnatoret në kuadër të këtij institucioni?	Fushë Kosovë	Janjevë	Total	Përqindja
PO	119	45	164	82%
JO	31	5	36	18%
Gjithsej	150	50	200	100%

Figura 25. Barnatoret në QKMF-ja

5.4.Përmirësimet në shërbimet shëndetësore në 12 muajt e fundit

Në komunën e Fushë Kosovës, nga totali i grave të intervistuar, 125 prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë vërejtur ndonjë përmirësim në shërbimet shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa 25 prej tyre kanë vërejtur përmirësime në këto shërbime.

Ndërsa në Janjevë, 43 prej grave nuk kanë vërejtur asnjë përmirësim në shërbimet shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit, kurse 7 prej tyre kanë vërejtur përmirësime në këto shërbime.

Informatat mund t'i shihni edhe në grafën e mëposhtëm:




Figura 26. Përmirësimet në 12 muajt e fundit

Nga gratë e intervistuar që kanë raportuar për përmirësime në shërbimet shëndetësore, ato kanë theksuar se kanë parë kujdes më të mirë nga mjekët, furnizim më të mirë me barna, përmirësim në pastërti dhe në fshatin e Janjevës, renovimi i objektit është vlerësuar si një përmirësim i rëndësishëm sipas grave të intervistuar.

Më poshtë, në grafe të ndara, mund të shihni specifikisht përmirësimet që gratë e këtyre komuniteteve kanë vërejtur në 12 muajt e fundit në komunën e Fushë Kosovës dhe në fshatin Janjevë.




Figura 27. Përmirësimet

6. SFIDAT

Përmes hulumtimit të këtij projekti ne kemi hasur edhe në disa sfida, secila duke na ofruar mundësi për të mësuar dhe përshtatur strategjitë tona.

Një ndër sfidat kryesore ishte mungesa e besimit. Disa gra janë përgjigjur me rezerva, e cila mund të ketë ardhur nga përvoja e diskriminimit të mëparshëm në përgjithsi. Kjo mund të ketë shkaktuar rezervë ose frikë për të ndarë informacion personal përvojën e tyre në këto ambiente

Gjuha ishte një tjetër sfidë. Disa të intervistuar në fshatin Janjevë nuk kanë kuptuar pyetjet dhe nuk kanë qenë të gatshme të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme. Megjithatë, përfshirja e një figure si Maksut Gashi, pjesëtar i komunitetit rom nga fshati i Janjevës, ka ndihmuar në lehtësimin e qasjes sonë me këto gra. Angazhimi i tij për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre ishte thelbësor për të tejkaluar pengesat dhe për të përfshirë gratë e këtyre komuniteteve në pyetësor.

Mungesa e informacionit rreth të drejtave shëndetësore ishte një sfidë tjetër. Shumë gra nga këto komunitete nuk ishin të informuara për shërbimet shëndetësore në dispozicion. Dhe një nga sfidat më të rëndësishme ishte fillimisht hezitimi i tyre për të përgjigjur.

Është e rëndësishme të pranojmë se përballimi i këtyre sfidave jo vetëm që ka zgjidhur problemet aktuale, por gjithashtu ka ndihmuar në ndërtimin e themeleve për një angazhim të vazhdueshëm me gratë e këtyre komuniteteve, duke siguruar një udhëtim më të qëndrueshëm dhe bashkëpunues në të ardhmen.

7. MËSIMET E MARRA

Gjatë implementimit të projektit 'Fuqizimi i grave dhe të rinjve rom, ashkali dhe egjiptianë në avokim dhe edukim shëndetësor' në Fushë Kosovë dhe Janjevë, përvojat tona na kanë dhënë një bazë të thellë të njohurive.

Një nga mësimet më të thella të nxjerra ishte rëndësia e angazhimit të thellë të grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë. Sfida në arritjen e komunitetit ashkali, në veçanti, na mësoi se mbështetja e udhëheqësve lokalë është thelbësore. Bashkëpunimi që krijuam me pjesëtarët e komuniteteve që njëkohësisht janë staf i organizatës The Ideas Partnership, Maksut Gashi dhe Arijeta Islami, ishte më shumë se një lëvizje strategjike; ishte një kujtesë se zemra e punës së komunitetit qëndron në forcën e marrëdhënieve personale dhe besimit. Gatishmëria e tyre për të mbështetur projektin brenda komunitetit të tyre ishte një pikë kthese dhe përsëriti vlerën e kontaktit personal në përpjekjet për mobilizimin e komunitetit.

Ndërgjegjësimi i grave në lidhje me të drejtat shëndetësore është thelbësor për të siguruar që ato të kenë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe të ndihen më të sigurta për të ndarë përvojën e tyre.

Ndërtimi i besimit dhe sigurimit të kujdesit dhe esenca e ndërtimit të besimit është thelbësore. Sigurimi i një mjedisit të sigurt dhe të bindshëm për gratë e komunitetit është kyç për të ndihmuar në përgjigjen e tyre në pyetjet dhe nevojat që mund të kenë.

Këto mësimet mund të ndihmojnë në përmirësimin e qasjes dhe strategjive për të siguruar një bashkëpunim më të mirë dhe të qëndrueshëm me gratë e këtyre komuniteteve në të ardhmen.

8. REKOMANDIMET

Bazuar në gjetjet nga ky hulumtim, D&D ka përpiluar rekomandimet përfundimtare që paraqesin nevojën e një përmirësimi të thellë në shërbimet shëndetësore në nivelet e furnizimit të barnave, ineksioneve, infuzioneve, dhe shërbimeve të nevojshme mjekësore bazike. Reformat dhe përmirësimi në këto fusha do të kishte një impakt thelbësor në qasjen dhe kujdesin shëndetësor për komunitetin, duke përmirësuar cilësinë dhe qasjen e kujdesit shëndetësor.

Rekomandimet me të detajuara:

- Furnizimin e QKMF-së të Fushë Kosovës dhe Janjevës me medikamente dhe mjete esenciale për trajtim, uljen e kostove për analiza dhe shërbime të tjera, si ultrazërat dhe procedurat e zakonshme mjekësore.
- Furnizimi i barnatoreve në QKMF-të e Fushë Kosovës dhe Janjevës me barna esenciale për pacientët.
- Nevoja e punësimit të mjekëve në departamentin e pediatriisë dhe gjinekologjisë në QKMF në Fushë Kosovë.
- Përmirësimi i transportit publik dhe sigurimi i qasjes në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Familjare (QKMF) për analiza dhe barna esenciale.
- Ndërtimi i programeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit për gratë në këto komunitete për të siguruar qasje më të lehtë dhe më të informuar në shërbimet shëndetësore.
- Ndërtimi i një bashkëpunimi më të thellë dhe më të përfshirë me komunitetin për të siguruar se nevojat dhe rekomandimet e tyre janë pjesë e zbatimit të politikave dhe masave të marra.

Këto rekomandime kërkojnë veprime konkrete që mund të ndihmojnë në adresimin e sfidave dhe në përmirësimin e qasjes dhe kujdesit shëndetësor për gratë në veçanti tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Rekomandimet në raport theksojnë nevojën për veprime të menjëhershme dhe zgjidhje afatgjata për të përmirësuar cilësinë dhe qasjen e kujdesit shëndetësor për komunitetin. Implementimi i këtyre rekomandimeve do të sjellë ndryshime të dukshme në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, duke i bërë ato më të qasshme dhe të përshtatshme për nevojat e komunitetit.

9. KONKLZIONI

Si përfundim, ky raport paraqet një rrugëtim të frytshëm dhe të përkushtuar drejt përmirësimit të situatës së grave në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë në aspektin e shërbimeve shëndetësore. Duke adresuar këto sfida, projektimi ka përbushur një mision të rëndësishëm: identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të qasjes dhe kujdesit shëndetësor për gratë në këto komunitete.

Nëpërmjet kësaj eksperience, janë evidentuar se sfidat si mungesa e qasjes në shërbimet shëndetësore, mungesa e informacionit dhe barrierat kulturore dhe gjuhësore janë reale dhe ndikuese për gratë në këto komunitete. Nëpërmjet angazhimit aktiv me komunitetin dhe përgjigjeve proaktive ndaj këtyre sfidave, është krijuar një platformë e rëndësishme për të ndërmarrë hapa në drejtim të përmirësimit të situatës së tyre shëndetësore.

Sfidat e hasura gjatë rrugës, megjithëse të rëndësishme, u ndeshën me zgjidhje proaktive që jo vetëm adresonin nevojat imediate, por gjithashtu ofronin mundësi mësimi që do të informojnë iniciativat tona të ardhshme.

Kjo analizë e thellë ka sjellë një përgjigje të përshtatshme, ku përmirësimi i politikave dhe qasjeve shëndetësore është thelbësore. Kjo ka nxitur edhe angazhimin e projektit për të përforcuar lidhjet me komunitetin, përmirësuar metodat e komunikimit dhe rikonfirmuar përkushtimin për ofrimin e një arsyeje të aksesueshme dhe të plotësuar të shërbimeve shëndetësore për gratë në nevojë.

Raporti përfundimtar shpalos një angazhim të vazhdueshëm për të vazhduar punën dhe përpjekjet e bëra deri më tani, duke synuar përparimin e shëndetit dhe qasjes së grave në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian drejt një të ardhme më të mirë dhe më të shëndetshme.

Ky raport që përmbledh punën tonë nga muaji Nëntor e deri në muajin Dhjetor, qëndron si një demonstrim i përkushtimit tonë dhe mendësisë bashkëpunuese të grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë dhe Janjevë.

10. Annex A – Pyetësi

SHËNIME DEMOGRAFIKE

Etnia:	<input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ashkali <input type="checkbox"/> Egjiptian
Vendbanimi:	<input type="checkbox"/> Fushë Kosovë <input type="checkbox"/> Janjevë
Mosha:	
Statusi Martesor	<input type="checkbox"/> Beqare <input type="checkbox"/> E martuar <input type="checkbox"/> E divorcuar <input type="checkbox"/> E ve
Nëse të martuar, në cilën moshë jeni martuar:	
A keni fëmije:	
Nëse po, sa fëmijë keni:	
Përfituese e Skemës Sociale:	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Sa janë të ardhurat e juaja mujore:	
Edukimi:	<input type="checkbox"/> Shkolla fillore <input type="checkbox"/> Shkolla e mesme <input type="checkbox"/> Univesitet <input type="checkbox"/> Pa edukim formal <input type="checkbox"/> Tjetër, specifiko: <input type="checkbox"/> Ndërprerja e mesimit
Nëse ndërprerja e mesimit, pse arsyeja:	
Punësimi	<input type="checkbox"/> E punësuar <input type="checkbox"/> E papunë <input type="checkbox"/> Studente <input type="checkbox"/> E pensionuar <input type="checkbox"/> Person me aftësi të kufizuara <input type="checkbox"/> Tjetër, specifiko:

QASJA NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE

1. A keni marrë shërbime shëndetësore?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Jo

1.1 Nese jo, pse?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht

2. Sa jeni të informuar për shërbimet shëndetësore?

- | | |
|--------------------------------------|--------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Shumë | <input type="checkbox"/> Pak |
| <input type="checkbox"/> Mesatarisht | <input type="checkbox"/> Aspak |

3. A keni qenë të prekur nga COVID-19?

- | | |
|-----------------------------|-----------------------------|
| <input type="checkbox"/> Po | <input type="checkbox"/> Jo |
|-----------------------------|-----------------------------|

3.1. Nëse po, ku jeni trajtuar?

- Spital Privat
- Spital Publik
- Në shtëpi

4. Nëse keni marrë shërbime shëndetësore cilat janë ato?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Kontrolle	<input type="checkbox"/> Kontrolle
<input type="checkbox"/> Konsulencë	<input type="checkbox"/> Konsulencë
<input type="checkbox"/> Maternitet	<input type="checkbox"/> Maternitet
<input type="checkbox"/> Shërbime të urgjencës	<input type="checkbox"/> Shërbime të urgjencës
<input type="checkbox"/> Rehabilitim	<input type="checkbox"/> Rehabilitim
<input type="checkbox"/> Kirurgji	<input type="checkbox"/> Kirurgji
<input type="checkbox"/> Të tjera specifiko:	<input type="checkbox"/> Të tjera specifiko:

5. Si do të përshkruanit qasjen tuaj në shërbimet shëndetësore?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Shumë e vështirë	<input type="checkbox"/> Shumë e vështirë
<input type="checkbox"/> E vështirë	<input type="checkbox"/> E vështirë
<input type="checkbox"/> Nuk kam kërkuar asnjëherë shërbim	<input type="checkbox"/> Nuk kam kërkuar asnjëherë shërbim
<input type="checkbox"/> E lehtë	<input type="checkbox"/> E lehtë
<input type="checkbox"/> Shumë e lehtë	<input type="checkbox"/> Shumë e lehtë

6. A ka ndonjë sfidë specifike që keni hasur kur keni kërkuar kujdes shëndetësor?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Jo

6.1. Nëse po, cila është ajo sfidë?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht

7. A keni pasur ndonjë pengesë kulturore, gjuhësore apo sociale për shkak të prejdardhjes së etnisë tuaj në marrjen e kujdesit shëndetësor?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Barrierë gjuhësore	<input type="checkbox"/> Barrierë gjuhësore
<input type="checkbox"/> Diferencat kulturore	<input type="checkbox"/> Diferencat kulturore
<input type="checkbox"/> Diskriminimi dhe paragjykimet	<input type="checkbox"/> Diskriminimi dhe paragjykimet
<input type="checkbox"/> Mungesa e informacionit dhe dijes	<input type="checkbox"/> Mungesa e informacionit dhe dijes
<input type="checkbox"/> Akses i kufizuar në shërbimet shëndetësore:	<input type="checkbox"/> Akses i kufizuar në shërbimet shëndetësore:

8. Sa jeni të kënaqur me performancën dhe shërbimet e institucioneve shëndetësore?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Shumë e kënaqur	<input type="checkbox"/> Shumë e kënaqur
<input type="checkbox"/> E kënaqur	<input type="checkbox"/> E kënaqur
<input type="checkbox"/> E pakënaqur	<input type="checkbox"/> E pakënaqur
<input type="checkbox"/> Aspak e kënaqur	<input type="checkbox"/> Aspak e kënaqur

8.1. Nëse aspak të kënaqur, cila është arsyeja?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht

9. A është marrë ndonjë masë për të mbështetur qasjen tuaj në shërbimet shëndetësore?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht
<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Po
<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Jo

9.1. Nëse po, çfarë ndihme keni pranuar?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht

9.2. Nëse po, nga kush keni pranuar ndihmë?

Gjatë pandemisë COVID-19	Aktualisht

10. A jeni në dijeni që mbas vizitave në QKMF, barnat esenciale ofrohen falas nga barnatoret në kuadër të këtij institucioni?

Po

Jo

11. A keni vërejtur ndonjë përmirësim në shërbimet shëndetësore në 12 muajt e fundit?

Po

Jo

11.1. Nëse po, çfarë përmirësime keni vërejtur?

11.2. Nëse jo, çfarë rekomandoni të përmirësohet në shërbimet shëndetësore?

Informata shtese: